

بيان سانت جالن

ಗಲಗ ಏನು ಠಗಱಱ

செங்காளன் தெரியப்படுத்துகிறது

॥ སཀ་གུ་ལན་གྱི་གསལ་བསྐྱབས།།

**ST.GALLER ERKLÄRUNG**  
FÜR DAS ZUSAMMENLEBEN DER RELIGIONEN  
UND DEN INTERRELIGIÖSEN DIALOG

**DEKLARATA E ST. GALLEN-IT**  
PËR BASHKËJETESËN E FEVE  
DHE DIALOGUN NDËRFETAR

### 1. Ne konstatojmë:

Sot në Kantonin St. Gallen jetojnë anëtarë të feve dhe besimeve të ndryshme: Krishtërimi, Judaizmi, Islami, Hinduizmi, Budizmi, Sikizmi, Bahaizmi dhe shumë të tjerë. Një numër i konsiderueshëm njerëzish nuk ndjen asnjë detyrë ndaj ndonjë feje. Shumë anëtarë të feve jo të krishtera janë të huaja dhe të huaj.

Të jetuarit bashkë në këtë larmi nuk është gjithmonë e lehtë. Shumë e konsiderojnë atë si një kërcenim. Këtë ne e marrim seriozisht. Bota e afërt ka nevojë të mbrohet dhe e bota e huaj të pranohet. Të dyja kanë të drejtë. Në të gjitha komunitete fetare ekzistojnë ankthe dhe paragjykime, rrënjët e të cilave shpesh zgjatin deri në një histori të rënduar.

### 2. Ne e vëmë veten në detyrim:

a) Ne heqim dorë nga të gjykuarit në mënyrë të përgjithshme për njerëz, të cilët kanë një besim tjetër. Ata t'i jenë besnik besimit të tyre dhe të kenë mundësinë të ndryshohen. Ne jemi të hapur për këtë, që komunitete fetare, në bisedë dhe në jetesë të përbashkët me njëri-tjetrin, të zbulojnë, të ndajnë, të japin më tej dhe të marrin të vërtetën.

b) Ne besojmë, që Perëndia i respekton të gjithë, të cilët e thirrin atë seriozisht, edhe nëse njerëz e quajnë dhe e nderojnë atë ndryshe. Prandaj ne miratojmë lutjen e feve të ndryshme në festa të përbashkëta dhe ne vëmë vëmendjen në këtë, që ndryshime të mos fshihen, por që ato bëhen të kuptueshme.

c) Ne ndërhyjmë për të Drejtat e Njeriut të të gjithëve. Referimi ndaj Perëndisë dhe ndaj fesë neve na detyron në mënyrë të veçantë, që t'i zbatojmë dhe t'i mbrojmë të Drejtat e Njeriut. Vëmendja jonë e veçantë i takon barazisë së të drejtave të grave.

d) Ne drejtohem nga parimi, që ndryshimet mes njerëzve, të cilat ekzistojnë dhe të cilat janë të nevojshme, lejohen të emërtohen, por ato janë relative. Ne të gjithë jemi krijesa të Perëndisë. Prandaj ne nxisim një kulturë të larmisë. Ne nuk kërkojmë të ruajmë identitetin tonë fetar dhe kulturor përmes izolimit ose përjashtimit, por ne duam të kontribuojmë me atë për një jetë të përbashkët në dialog. Ne ndërhyjmë për një shoqëri të larmishme, por të integruar sa më mirë, në bazë të vlerave parimore humanitare dhe në bazë të të qenit një shtet juridik demokratik.

e) Ne përjetojmë radikalizëm dhe fundamentalizëm, pavarësisht në cilën fe ata shfaqen, si forma jo tolerante të besimit, të cilat mbjellin urrejtje dhe frikë dhe prodhojnë dhunë. Ne distancohem nga çdo lloj ekstremizmi, i cili kërcënon, gjykon ose sulmon njerëz me koncepte të tjera. Nga që fetë tona na vënë në detyrë për tolerim dhe paqe, ne kërkojmë me ngulm dhe durim bisedën dhe bashkëjetesën ndërfetare.

St.Gallen me 9 shtator 2015

**Martin Klöti**

Këshilltari i Qeverisë  
Kryetar ne Departamentin  
e Punëve të Brendshme

**Markus Büchel**

Peshkopi i St.Gallen-it

**Anita Pawar**

Përfaqësuesja e Komunitetit Hinduiste

**Tovia Ben - Chorin**

Rabini i Bashkësisë Judaiste  
St.Gallen

**Gurdeep Singh Kundan**

Përfaqësuesi i Sikëve

**Nino Cozzio**

Këshilltari i Bashkisë St.Gallen

**Prifti Martin Schmidt**

Presidenti i Këshillës së Kishës  
Kisha Ungjillore e Reformuar  
e Kantonit St.Gallen

**Silvia Fröhlich**

Përfaqësuesja e Tavolinës  
Rrumbullake të Fëve St.Gallen  
dhe Krahinë, Përfaqësuesja e  
Bahaive

**Bekim Alimi**

Presidenti i përkohshëm, DIGO  
(Çatia e Komuniteteve Islame  
të Zvicrës Lindore dhe të Principatës  
Lihtenshtajn)

**Daniel Konrad**

Prifti i Kishës Bashkësie e  
Krishtere Katolike